



Në bazë të pikës 12-12.2 të Programit të aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit jetësorë dhe të natyrës në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2018 ("Lajmëtari zyrtarë i Qytetit të Shkupi" nr. 12/7), Sektori për mbrojtjen e mjedisit jetësorë dhe të natyrës shpall:

**Thirrje publike
për tubimin e kërkesave
për shfrytëzim të mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018,
të përcaktuar për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave civile dhe
fondacioneve**

Shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018, nga Programi R1, nën-zëri 463190 – Transferime deri te organizatat civile dhe fondacionet, do të kryhet në përputhje me Kodeksin e praktikave të mira për përkrahjen financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 130/07), dhe në bazë të Programit për aktivitetet e Qytetit të Shkupit nga fusha e mbrojtjes së ambientit jetësor dhe natyrës në territorin e Qyteti të Shkupit për vitin 2018 dhe në bazë të kriterëve dhe prioritetëve të dhëna në këtë thirrje publike.

1. Përshkrim i shkurtër:

Mjetet nga buxheti i Qytetit të Shkupit do të shfrytëzohen për financimin e projektit qëllimi i të cilit është ngritja e vetëdijes publike për shfrytëzimin e zgjidhjeve alternative të komunikacionit, nëpërmjet pjesëmarrjes në Javën evropiane të mobilitetit. Aktivitetet duhet t'u përgjigjen kushteve të mëposhtme të Javës së mobilitetit me temën: **„Multimodality – Mix and Move” – “Kombinohu dhe lëviz”**. Tema ka të bëjë me planifikimet e zgjuara dhe shfrytëzimin e transportit publik alternativ dhe të transportit të kombinuar gjë me të cilën do të ndihmohet në zvogëlimin e ndikimeve negative të automjeteve.

Në suazat e organizimit të aktiviteteve programore ofertuesi duhet:

- Të parashikojë një numër të madh evenimentesh (punëtori, ligjërata, promociione, manifestime dhe evenimente) me përmbajtje të ndryshme, pjesëmarrës dhe organizatorë, që do të jenë të lidhura me temën e manifestimit të sivjetmë,
- Të përgatisë promocionin e të gjitha masave permanente të Qytetit të Shkupit nga fusha e transportit të qëndrueshëm dhe alternativ, kombinimin e transportit dhe mbrojtjes së ambientit jetësor, të lidhura me temën e evenimentit,
- Të përgatisë pjesën përfundimtare të manifestimit – Ditë pa automobila dhe defile e biçikletave.

Aktivitetet e parashikuara duhet të jenë inovative, adekuate me temën, frymëzuese, të sigurojnë pjesëmarrje masive të qytetarëve nga të gjitha moshat, të jenë edukative, argëtuese, interesante, me një fjalë java në të cilën mbahet në mënyrë tradicionale

ENM 16.-22.09, të jetë e kompletuar me një numër të madh evenimentesh të ndryshme.

Si palë të interesuara në organizimin e evenimenteve mund të jenë: Sektorët e Qytetit të Shkupit, ndërmarrjet publike, institucionet nga fusha e kulturës, shkollat e mesme etj.

2. Mjete të parashikuara gjithsej

Për financimin e aktiviteteve programore të ofruara, në përputhje me thirrjen publike, do të shfrytëzohen mjetet nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018, me vlerë të përgjithshme 500.000,00 denarë.

3. Korniza kohore

Afati përfundimtar për realizimin e projektit është 22 Shtator 2018. Afati për dorëzimin e raportit për realizimin e projektit është 22 tetor 2018. Shfrytëzimi i mjeteve do të specifikohet në kontratën ndërmjet shoqatës civile dhe Qytetit të Shkupit.

4. Kriteret themelore organizative

Kriteret kryesore organizative të cilat duhet t'i plotësojnë shoqatat civile dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Të jenë të regjistruara në përputhje me Ligjin për shoqata civile dhe fondacione me seli në Shkup;
- Të merren me aktivitete dhe projekte të interesit publik;
- Të mos kenë fituar mjete ose të mos kenë parashtuar fletëparaqitje nga/deri tek organe të administratës shtetërore ose burime të jera për të njëjtin qëllim dhe aktivitete për të cilin parashtrojnë fletëparaqitje, që do të nënkuptonte financim të dyfishtë të të njëjtave aktivitete nga burime të ndryshme.

5. Dokumentacioni i detyrueshëm për aplikim

Shoqatat dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në thirrjen publike duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje të plotësuara kompjuterike për përkrahje financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve, të nënshkruara nga përfaqësuesi i shoqatës civile ose fondacionit të vërtetuar me vulë të shoqatës civile ose fondacionit;
- Formular i plotësuar kompjuterik për propozim – projektin;
- Statut i shoqatës civile ose fondacionit;
- Fotokopje nga aktvendimi për regjistrimin e shoqatës civile ose fondacionit;
- Raport për mjetet e fituara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin e kaluar kalendarik dhe mënyrën e realizimit të tyre (nëse organizata ka qenë përfitues i mjeteve të ndara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2017);
- Raport vjetor i shoqatës civile ose fondacionit për vitin paraprak;
- Fotokopje nga llogaria përfundimtare për vitin paraprak;
- Vërtetim për pagimin e tatimeve të lëshuar nga organet tatimore.

Vërejtje: Fletëparaqitjet me dokumentacion të paplotë ose të dorëzuara pas afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen!

Shtojcat e dorëzuara nuk kthehen.

6. Dokumentacioni përcjellës:

Shoqatat civile dhe fondacionet si shtojcë mund të dorëzojnë edhe këto dokumente përcjellëse:

- Biografi profesionale e personave profesional që do të angazhohen në realizimin e projektit;
- Listë referimi ose dëshmi (për shembull: kontratë të nënshkruar) për së paku 2 projekte të realizuara në fushën për të cilën aplikojnë;
- Më së paku 2 mendime (referenca) nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme;
- Përkrahje me shkrim nga organizata tjera dhe/ose institucione për të cilat është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit.

7. Vlerësimi i kualitetit të projekteve

Vlerësimin e propozimeve të arritura për projektet, do ta realizojë Komisioni i formuar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit, në bazë të kriterëve vijuese:

KRITERET PËR VLERËSIM	PIKËT MAKSIMALE
1. Struktura organizative dhe resurset	40
1.1. Kapaciteti i Organizatës në raport me resurset njerëzore për realizimin e projektit (të punësuarit, vullnetarët aktiv, personat e angazhuar me honorar)	10
1.2. Profesionaliteti i personave që marrin pjesë në realizimin e projektit	10
1.3. Përvoja e Organizatës në realizimin e projekteve të një volumi të tillë në fushën përkatëse	10
1.4. Mundësitë hapësinore dhe teknike të Organizatës për realizimin e projektit	5
1.5. Aftësia për udhëheqje me buxhetin (a e tejkalon vlerën e grandit buxheti vjetor i shoqatës civile dhe fondacionit për vitin e fundit kalendarik)	5
2. Kualiteti i projektit	60
2.1. Sa do të kontribuojë qëllimi i përgjithshëm i projektit për realizimin e prioriteteve të caktuara, sa është i qartë, i realizueshëm dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate	15
2.2. Zgjidhjet e ofruara cilësore dhe inovative për realizimin e qëllimeve programore	20
2.3. Aktivitetet programore të përgatitura në mënyrë të detajuar	10
2.4. Vlerësimi i justifikimit të shpenzimeve të propozim planit financiar (buxheti real në lidhje me aktivitetet dhe numrin e personave të angazhuar, përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve dhe sa të njëjtat korrespondojnë me çmimet e	10

tregut)	
2.5. Vlerësimi për pjesëmarrjen në organizimin e Projektit të paraparë me mjete financiare të siguruar nga burimet individuale dhe burimet tjera (për pjesëmarrje individuale prej 15%, aplikuesi fiton maksimum 15 pikë)	5
Numri maksimal i përgjithshëm i pikëve	100

8. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve është data **15.06.2018 deri në orën 15:00**.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e plotë dorëzohet nëpërmjet postës, në adresën:

Qyteti i Shkupit,

Spektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës,

bul. "Ilindenska" 82

1000 Shkup,

ose në arkivin e Qytetit të Shkupit nga ora 08.30 deri më 16.30. (me emërtim – **Spektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës – Fletëparaqitje për thirrjen publike për OJQ për vitin 2018**).

Shoqatat civile ose fondacionet pjesëmarrëse në thirrjen publike do të informohen për rezultatet në afat prej 7 ditësh nga dita e sjelljes së Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018 të destinuar për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave civile dhe fondacioneve.

Fletëparaqitja për përkrahje financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve, si dhe Formulari për Propozim – projektin mund të merren në ueb-faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Pyetje për sqarime plotësuese mund të parashtrihen në formë të shkruar ose nëpërmjet formës elektronike deri te Spektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës në adresën: infoekologija@skopje.gov.mk.

Kontakti: Spektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës, tel: 02/ 3297 273; E-mail adresa: infoekologija@skopje.gov.mk.